



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër:400-01/13479, datë: 27 Shkurt 2024.

Në bazë të nenit 12.pika 2 (d), të Ligjit Nr.03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës datë: 04.Qershor 2008 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 datë: 04.Qershor 2008) nenit 20 paragrafi 1, pika 1.4. dhe nenit 84. paragrafi 1, pika 1.4. të Statutit të Komunes së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 27 Shkurt 2024, pas shqyrtimit të Draft Strategjisë Komunale kundër dhunës në Familje 2024-2027 dhe Planit të Veprimit për parandalimin e dhunës në familje 2024-2027, në Komunën e Pejës, merr:

VENDIM
Nr. 06/2024

Mbi miratimin në parim dhe dhënjen në diskutim publik të Draft Strategjia Komunale kundër dhunës në Familje 2024-2027 dhe Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje 2024-2027

I. IPET në Diskutim Publik: Draft Strategjia Komunale kundër dhunës në Familje 2024-2027 dhe Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje 2024-2027

II. Diskutimi Publik zgjat 14 ditë, nga dita e shpalljes – paraqitjes së Draft – Strategjisë dhe Planit të Veprimit në Tabelen e shpalljeve publike dhe në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.

III. Qytetarët e Interesuar mund të njoftohen me tekstin – përmbajtjen e Draft – Planit të lartë cekur, përmes Drejtorisë për Mirëqenie Sociale (DMS) të Komunës së Pejës.

IV. Vërejtjet dhe sugjerimet eventuale në Draft – Strategjinë dhe Planin e Veprimit, mund të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen përmes Zyrës së pranimit – Arkives, për DMS të Komunës së Pejës, si dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

V. Vërejtjet dhe sugjerimet duhet të paraqiten vetëm me shkrim dhe në kohën e afatit caktuar me këtë vendim, ngase vërejtjet e paraqitura jashtë afatit nuk do të mirrën parasysh.

Vendimi ti dërgohet:

1x1. DMS,
1x1. Arkivë.

